



KB

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE

Nr. 3850 prot.Vlorë, më 2005.2026

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, datë _____. 2026

PËR

MIRATIMIN E VLERËS FINANCIARE TË DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA DJEGIA E BANESËS TË ZNJ.DOLOREZA BUQE DHE SHPËRBLIMIN FINANCIAR NGA ANA E BASHKISË VLORË.

Këshilli i Bashkisë Vlorë në zbatim të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8 pika 2, neni 9/1 pika b, neni 29/1, neni 54 pika dh ,të ligjit nr.45/2019 datë 18.07.2019 “Për Mbrojtjen Civile”, në VKM Nr. 329 data 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore” paragrafi III/ë, pasi mori në shqyrtim materialin e përgatitur nga Drejtoria e Mbrojtjes Civile, Drejtoria e Financës dhe Këshilli i Qarkut Vlorë,

VENDOSI:

1. Të miratojë vlerën financiare të dëmeve të shkaktuara nga djegia në banesën e znj.Doloreza Buqe, e ndodhur në lagjen “1 Maji”, Rajoni Nr.4, Bashkia Vlorë, në datën 24.12.2025, sipas preventivit të hartuar nga ekspertët e Këshillit të Qarkut Vlorë përkatësisht në masën:

A. 163,182(njëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e njëqind e tetëdhjetë e dy) lekë për punime ndërtimi (326,364x50%).

B. 485,563(katërqind e tetëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e tre) lekë për mobilje dhe pajisje elektroshtëpiake.

2. Shpërblimi financiar do të përballohet nga fondi i kushtëzuar i buxhetit të shtetit për Mbrojtjen Civile të Bashkisë Vlorë.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financë-Buxhetit dhe Drejtoria e Mbrojtjes Civile pranë Bashkisë Vlorë.

4. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015,neni 55 pika 6.

KRYETAR

Brunilda Mersini

ME URDHËR DELEGIMI

NËNKRYETAR

Joljana Llanaj

